

### Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA) nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi

#### Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për muajin janar 2021

#### Publikime Profesionale

BIS	COVID-19 dhe rreziku kibernetik në sektorin financiar
IOSCO	IOSCO publikon programin e punës për 2021-2022
IAIS	IAIS publikon programin e punës për 2021-2022
EIOPA	EIOPA adreson masat për të përmirësuar sigurimin e rrezikut të ndërprerjes së biznesit gjatë periudhës së pandemisë

#### Informacione Ndërkombëtare

Estoni      Greqi      Kosovë      Republika Çeke      Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

# Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA) nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi

Faqe Kryesore ▶ Media ▶ AMF dhe HANFA nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



© 23 Shkurt 2021

## AMF dhe HANFA nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

Memorandumi i Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë Kroate të Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare rregullon shkëmbimin e informacionit në funksion të mbikëqyrjes, si edhe përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve për tregjet e kapitaleve, sigurimeve dhe pensioneve private vullnetare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA) kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi, në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy rregullatorëve. Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete dhe Presidenti i Bordit të HANFA-s, z. Ante Žigman.

Marrëveshja rregullon shkëmbimin e informacionit në funksion të mbikëqyrjes, si edhe përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve. Marrëveshja e re, krahas tregjeve të kapitalit, zgjeron bashkëpunimin edhe në lidhje me tregun e sigurimeve dhe pensioneve private vullnetare.

“Ky Memorandum Mirëkuptimi vendos linja të qarta bashkëpunimi mes AMF dhe HANFA, në kuadër të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Autoriteti do të përfitojë në veçanti nga eksperiencia dhe asistenca kroate në ato fusha specifike ku HANFA zotëron një ekspertizë të thelluar si rregullatori i një shteti të BE-së,” u shpreh z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së.

“HANFA i ka dhënë tashmë asistencë teknike kolegëve shqiptarë në disa raste, në funksion të harmonizimit të rregulloreve me kuadrin ligjor evropian. Kjo marrëveshje paraqet një kuadër për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit, i cili me siguri do të intensifikohet në momentin kur Shqipëria të nisë negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian,” theksoi Presidenti i Bordit të HANFA-s, z. Ante Žigman.

Në bazë të marrëveshjes, Autoriteti do të përfitojë nga asistenca kroate në kuadër të mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve dhe mbikëqyrjes së konsoliduar të tregjeve, përgatitjes për regjimin Solvency II, digjitalizimin dhe përmirësimin e sistemeve të raportimit dhe analizës, edukimin financiar, etj.

# VËSHTRIM MBI TREGJET


## Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për janar 2021

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar 2021 arritën vlerën mbi 1,500 milionë lekë, ose 9.07% më shumë se në muajin janar 2020. Gjatë muajit janar 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 71,184 me një ulje prej 29.81% krahasuar me janar 2020.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.70 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.30%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 45.95% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 54.05% të totalit të tregut.

Gjatë muajit janar 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 541 milionë lekë, ose 28.07% më pak se në janar 2020.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar 2021 (Në %)



Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar 2021 arritën vlerën mbi 1,500 milionë lekë, ose 9.07% më shumë se në muajin janar 2020.

- Research & publications
- Research at the BIS
- Trending topics >
- BIS authors
- Annual Economic Report
- Quarterly Review >
- BIS Bulletins

## Covid-19 and cyber risk in the financial sector

BIS Bulletin | No 37 | 14 January 2021  
by [Iñaki Aldasoro](#), [Jon Frost](#), [Leonardo Gambacorta](#) and [David Whyte](#)  
[PDF full text \(770kb\)](#) | 9 pages

### Key takeaways

- The financial sector has been hit by hackers relatively more often than other sectors during the Covid-19 pandemic.
- While this has not yet led to significant disruptions or a systemic impact, there are substantial risks from cyber attacks for financial institutions, their staff and their customers going forward.
- Financial authorities are working to mitigate cyber risks, including through international cooperation.

## COVID-19 dhe rreziku kibernetik në sektorin financiar

[www.bis.org](http://www.bis.org)

Iñaki Aldasoro, Jon Frost, Leonardo Gambacorta dhe David Whyte

Rreziku kibernetik është një term ombrellë që përfshin një gamë të gjerë rreziqesh që rezultojnë nga dështimi ose prishja e sistemeve të IT-së. Ndërsa ekonomia dhe sistemi financiar bëhen më të digjitalizuara, rreziku kibernetik bëhet më i madh. Gjatë pandemisë COVID-19, institucionet financiare kanë qenë aktor kryesor në përgjigje ndaj rrezikut kibernetik.

Ekspozimi i institucioneve financiare ndaj rrezikut kibernetik është theksuar më tej nga ndryshime organizative si puna nga shtëpia. Zhvendosja e shumicës së aktiviteteve në botën dixhitale lë hapësirë për rritjen e rrezikut të sulmeve kibernetike. Nëse nuk menaxhohet mirë, kjo mund të krijojë mundësi të reja për të depërtuar në sistemet e IT-së dhe për të kryer sulme kibernetike dhe lloje të tjera të krimit financiar.

Sipas studimit të kryer, që nga fillimi i pandemisë sektori financiar është goditur më shpesh nga sulmet kibernetike sesa shumica e sektorëve të tjerë. Ndaj gjatë procesit të politikëbërjes duhen marr parasysh dy trende. Së pari, puna në distancë ka të ngjarë të mbetet më e lartë se në periudhën para-Covid-19, ndaj planet e vazhdimësisë së biznesit të hartuara për ndërprerje afatshkurtra mund të kenë nevojë të përshtaten me situatën e punës nga shtëpia për periudha më të gjata, dhe proceset e biznesit mund të kenë nevojë të përshtaten me "normalitetin e ri".

Së dyti, institucionet financiare ka të ngjarë të vazhdojnë të zhvendosin pjesë të operacioneve të tyre të IT në *clouds*. Një studim i fundit tregon se 82% e ndërmarrjeve kanë rritur përdorimin e *clouds* si rezultat i pandemisë së koronavirusit dhe 91% po planifikojnë ta përdorin atë në të ardhmen e afërt. Nëpërmjet *software* të përbashkët, *clouds*, dhe përdorimit të kompjuterave personal gjatë punës nga shtëpia incidentet, në parim, mund të përhapen më shpejt, duke çuar në humbje më të mëdha për institucionet financiare dhe stres në sistemin financiar në tërësi.

Bërësit e politikave dhe bizneset po punojnë në mënyrë aktive së bashku për të zbutur rreziqet kibernetike dhe implikimet e tyre sistemike. Për shembull, shumë organizata të sektorit privat dhe publik po forcojnë qëndrueshmërinë e tyre operacionale dhe shumë prej tyre po kryejnë simulime të sulmeve kibernetike, të cilat ndihmojnë për të identifikuar dobësitë dhe për të rritur gatishmërinë dhe linjën e komunikimit.



## IOSCO publikon programin e punës për 2021-2022

<https://www.iosco.org/>

Bordi i IOSCO-s publikoi programin e tij të punës për vitet 2021-2022.


Ky program përfshin objektivat kryesore për mbrojtjen e investitorëve, promovimin e tregjeve të drejta, efikase dhe transparente, si dhe adresimin e rreziqeve sistemike.

Programi i punës, ndryshe nga botimet e mëparshme, mbulon një horizont dy-vjeçar, i cili do të rishikohet në fund të vitit 2021.

Programi i punës për vitet 2021-2022 përfshin punën në lidhje me dy përparësi të reja, përkatësisht:

1. Stabiliteti financiar dhe rreziqet sistemike të aktiviteteve të ndërmjetësimit financiar jobankar;
2. Rreziqet e përkeqësuar nga pandemia COVID-19, si zbatueshmëria, mashtrimet dhe qëndrueshmëria operacionale.

Me shqetësime të vazhdueshme për ndikimin e COVID-19 në aktivitetin ekonomik global dhe parashikimin makro-financiar, programi i punës së 2021-2022 përmes këtyre dy përparësive të reja, kërkon mbajtjen e një fokusi thelbësor në punën kritike që po zhvillohet që nga marsi i vitit 2020 për t'iu përgjigjur ndikimeve të vazhdueshme të pandemisë në tregjet e kapitalit.



## IAIS publikon programin e punës për 2021 - 2022

<https://www.iaisweb.org/>

*Roadmap-i* i IAIS për vitet 2021-2022 është hartuar gjatë një kohe pasigurie të paprecedentë për shkak të pandemisë Covid-19. Pandemia ka pasur një ndikim të madh shëndetësor dhe shoqëror në të gjithë globin, ndërsa ka shkaktuar gjithashtu përçarje të konsiderueshme ekonomike, shtrirja e plotë e së cilës mbetet e panjohur ende.

Pandemia gjithashtu ka pasur një ndikim në aktivitetet e IAIS, duke e udhëhequr Shoqatën për të rregulluar modelin dhe operacionet e saj të biznesit gjatë gjithë vitit 2020. Ashtu si shumica e organizatave, IAIS ka kaluar nga marsi i vitit 2020 në një "normale të re" të stafit që punon në distancë dhe operacioneve që zhvillohen virtualisht.

Pavarësisht nga sfidat e rëndësishme, IAIS ka vazhduar të përparojë në mënyrë efektive aktivitetet kryesore në vitin 2020, ndërsa mbetet e vetëdijshme për ndikimin e krizës tek Anëtarët të cilët po mundohen të menaxhojnë situatën Covid-19.

Duke u bazuar në përvojat e vitit 2020, Udhërrëfyeni 2021-2022 pranon rëndësinë e mbështetjes së Anëtarëve të IAIS në përgjigjen ndaj Covid-19, ndërsa njëkohësisht nuk humbet fokusin në reformat kryesore dhe objektivat strategjike të përcaktuara në Planin Strategjik të IAIS 2020-2024.

Roadmap 2021-2022 përcakton projektet specifike që IAIS do të ndërmarrë (ose vazhdojë) gjatë dy viteve të ardhshme, si aktivitetet e vazhdueshme që mbështesin punën e Forumit të Përfshirjes Financiare (FIF), Forumit FinTech (FF), Forumit të Të Ardhurave të Pensioneve (RIPF), si dhe bashkëpunimin me organizata të jashtme dhe angazhimin rajonal.

IAIS do të monitorojë vazhdimisht dhe do të përgjigjet sfidave, të tilla si ato që dalin nga pasiguritë e vazhdueshme Covid-19, që mund të ndikojnë në përpjekjen e Shoqatës për të arritur objektivat e saj.

## EIOPA addresses measures to improve the insurability of business interruption risk in light of pandemics

NEWS | DATE: 12 Feb 2021



### EIOPA adreson masat për të përmirësuar sigurimin e rrezikut të ndërprerjes së biznesit gjatë periudhës së pandemisë

<https://www.eiopa.europa.eu/>

EIOPA ka publikuar një artikull mbi masat për të përmirësuar sigurimin e ndërprerjes së biznesit gjatë pandemisë. Në këtë artikull analizohen opsionet që lidhen me masat parandaluese për të zvogëluar humbjet, transferimin e rrezikut në tregjet e kapitalit dhe zgjidhjet për rrezikun sistemik. Adreson gjithashtu sfidat e përgjithshme në lidhje me modelimin dhe shkaktarët e pretendimeve të dëmeve në kontekstin e pandemisë.

EIOPA thekson se një element kryesor është parandalimi, ndaj duke promovuar masa parandaluese, siguruesit mund të përmirësojnë kapacitetin e shoqërisë për të zvogëluar humbjet. Përmirësimi i qartësisë në fushën e mbulimit si dhe integrimi i masave parandaluese në çmimet e bazuara në rrezik të mbulimit të sigurimeve mund të kontribuojnë në shfaqjen e kostos së vërtetë dhe krijimin e stimuljve për sjelljen parandaluese. Parandalimi mund të mbështetet nga stimuj rregullatorë, si dhe nga iniciativa publike-private për ndarjen e të dhënave. Përafrimi i masave publike-private për parandalimin e rrezikut mund të ndihmojë në zvogëlimin e rrezikut moral dhe të përmirësojë sigurueshmërinë e rrezikut.

Për të përmirësuar kapacitetin e shoqërisë për të mbajtur rrezikun e ndërprerjes së biznesit, përtej mekanizmave tradicionalë të sigurimit, tregjet e kapitalit mund të jenë një mënyrë efiçente për transferimin dhe diversifikimin e rrezikut. Krijimi i instrumenteve të rinj dhe të suksesshëm të tregjeve të kapitalit për financimin e rrezikut të ndërprerjes së biznesit në një krizë pandemike paraqet sfida dhe kërkon siguri ligjore, parashikueshmëri dhe shpejtësi në pagimin e dëmeve. Nevojitet kujdes në modelimin dhe çmimin e rrezikut pandemik, aty ku është e mundur stimulimi i parandalimit të rrezikut përmes shkaktarëve përkatës të pretendimeve për dëmshpërbim.

## REPUBLIKA ÇEKE

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Republikën Çeke e mbylli vitin 2020 me një rritje prej 4.91 miliardë CZK (korona, monedha vendase) në prime të shkruara.

Sigurimi i jetës arriti 46.54 miliardë CZK në vitin 2020 duke u rritur me 3.1%, krahasuar me 2019. Megjithatë numri i kontratave të sigurimit të jetës ka pësuar ulje përgjat vitit të kaluar. Më 31 dhjetor 2020 kishte 5.05 milionë kontrata aktive, ose 87 mijë më pak se një vit më parë.

Lidhur me zhvillimin e tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, viti 2020 u mbyll me 3.9% rritje të primeve të shkruara bruto, krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020, kompanitë e sigurimeve paguan 83,000 kërkesa dëmshpërblimi për sigurimin e pronës, të shkaktuara kryesisht nga përmytje, stuhi ose breshër, në shumën totale prej rreth 2.96 miliardë CZK. Zakonisht, kur nuk ka ngjarje të jashtëzakonshme katastrofash, siguruesit kanë mesatarisht rreth 38,000 kërkesa dëmshpërblimi për sigurimin e pronës. Në vitin 2020, numri i dëmeve në sigurimin e pronës tejkaloi mesataren me 117% dhe me 82% në rastin të shumës së paguar të dëmshpërblimit. Arsyeja kryesore për këtë ishte uragani "Sabine" që goditi vendin, si edhe dëmtimet e shkaktuara nga përmytjet.



## KOSOVA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës, tregu i sigurimeve ka raportuar një fitim neto prej 4.1 miliardë Euro në fund të vitit 2020. Kjo përbën një rritje të konsiderueshme, krahasuar me vitin 2019, kur kompanitë e sigurimeve në Kosovë raportuan humbje prej -2.8 milion Euro.

Në të njëjtën kohë, asetet e kompanive të sigurimit u rritën në një vlerë prej 220.5 milionë Euro, krahasuar me 193.9 milionë Euro që ishin në fund të vitit 2019.

Sa i përket primeve të shkruara bruto, tregu i sigurimeve të Kosovës mbeti pothuajse në nivelin e vitit 2019, duke arritur një vlerë prej 101.52 milionë Euro.

Sa i përket dëmeve, vlera totale e paguar nga siguresit pësoi rënie me 4 milionë Euro, duke arritur në 51.5 milionë Euro përgjatë vitit 2020.

Sigurimi i Jetës arriti në 3.6 milionë Euro prime të shkruara bruto, ose 2.9% më shumë se në tyvitin 2019. Ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës ishin thuajse të njëjta me vitin 2019, duke arritur në 97.9 milionë Euro.

## GREQIA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimeve, tregu grek i sigurimeve e mbylli vitin 2020 me 3.92 miliardë Euro prime të shkruara bruto, me një rënie prej 3.7% krahasuar me vitin 2019.

Sipas shifrave të paraqitura të fundvitit, segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës mbeti pothuajse në nivelin e vitit 2019 me 2.10 miliardë Euro prime të shkruara bruto.

Përsa i përket tregut të Jetës, siguresit grekë arritën 1.81 miliardë Euro prime të shkruara bruto, ose 8% më pak sesa në vitin 2019.

## TURQIA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Turqi u rrit me 19.26% në vitin 2020, duke raportuar 82.57 miliardë TRY (lira, monedha vendase) prime të shkruara bruto.

Në krahasim me shifrat e vitit 2019, gjatë vitit 2020 nuk kishte ndryshime të rëndësishme në portofolin e sigurimeve. Kështu, sigurimi i Jetës përbën 17.48%, përkundrajt 16.41% të tregut që ishte në vitin 2019, ndërsa tregu i Jo-Jetës ruajti peshën e tij të portofolit thujtë të pandryshuar nga një vit më parë.

## ESTONIA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Bordi Kombëtar i Statistikave Estoneze botoi të dhënat për vitin 2020, ku rezulton se tregu i sigurimeve në Estoni pësoi rënie me 5% të primeve të shkruara bruto, krahasuar me vitin 2019, duke arritur në 468.86 milionë Euro.

Segmenti i sigurimeve të Jetës u zvogëlua me 10.79%, duke arritur vlerën prej 85.56 milionë Euro prime të shkruara bruto, ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës, arriti vlerën prej 383.3 milion EUR, duke pësuar një rënie prej 3.68% krahasuar me vitin 2019.

Për sa i përket dëmeve, gjatë vitit 2020 siguruesit estonezë kanë paguar dëmshpërblime me vlerë 276.76 milion EUR, ose 3 milion EUR më pak krahasuar me vitin 2019. Dëmshpërblimet në sigurimet e jetës arritën vlerën prej 63.18 milion EUR (kundrejt 61.10 milion EUR një vit më parë), ndërsa dëmshpërblimet në sigurimet e jo jetës arritën vlerën prej EUR 213.58 milion, duke pësuar një rënie prej 2%.



---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)